



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 4, Datë 09.09.2015

**P Ë R**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “SISTEMIMIN E HYRJES SË GODINËS  
SË DREJTORISË SË POLICISË SË SHTETIT”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 19 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Sistemimin e hyrjes së godinës së Drejtorisë së Policisë së Shtetit”, me vendndodhje në territorin e Bashkisë Tiranë, me subjekt kërkues Drejtoria e Policisë së Shtetit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturës bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**E D I R A M A**

**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**

**SAIMIR TAHIRI**

**MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME**

**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**